

PASQYRAT FINANCIARE

PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2012

Se bashku me Raportin e Audituesit

Universiteti POLIS Sh.p.k.



Permbajtja

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	3
BILANCI KONTABËL	4
BILANCI KONTABËL (VAZHDIM)	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	6
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	7
PASQYRA E NDRYSHIMIT TE KAPITALEVE	8
SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE	9 - 19

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar:

ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE "Universiteti POLIS" shpk

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë "Universiteti POLIS" shpk (më poshtë "Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 Dhjetor 2012 dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyren e ndryshimeve në kapital dhe pasqyren e flukseve të parase për vitin e përfunduar në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rendesishme kontabel si dhe informacionin tjetër shjegues.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabile; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabile të arsyeshme për rrethanat financiare.

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin tone. Ne kryem auditimin tone në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.


Një auditimim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhena në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalise materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit. Gjatë berjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim gjithashtu përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabel të përdorura dhe arsyeshmerise se çmuarjeve kontabel të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Shoqërisë "Universiteti POLIS" shpk me datën 31 Dhjetor 2012, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standartet Kombetare të Kontabilitetit.

ILD-99 Audit shpk


Irena Hoxha (Pulo)

Eksperente Kontabelig Regjistruar



Tirane, me 29 Mars 2013

Universiteti POLIS sh.p.k

Pasqyra financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, perveç kur shprehet ndryshe)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2012

AKTIVET	Shenime	31.12.2012	31.12.2011
Mjetet Monetare	4	3,398,558	5,803,849
Derivate dhe Aktive Financiare te mbajtur per tregtim		-	-
Totali		3,398,558	5,803,849
Aktive te tjera Financiare afatshkurter		-	-
Llogari kerkesa te arketueshme	5	7,286,212	3,945,656
Llogari kerkesa te tjera te arketueshme	6	8,387,152	4,871,756
Instrumente te tjera borxhi		-	-
Investime te tjera financiare		-	-
Totali		15,673,364	3,945,656
Inventari		1,029,880	-
Lendet e para		-	-
Prodhimi ne proces		-	-
Produkte te gatshme		-	-
Mallra (libra)		1,029,880	-
Inventar I Imet		-	-
Parapagesat per furnizime		-	-
Totali	7	1,029,880	-
Aktive Biologjike afatshkurter		-	-
Aktive Afatshkurtra te mbajtur per shitje		-	-
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	8	3,435,283	1,110,599
Total i Aktiveve Afatshkurtra		23,537,085	15,731,860
Aktive Afatgjata		97,167,411	94,307,789
Investime financiare afatgjata		52,409,584	55,167,983
Totali		97,167,411	94,307,789
Aktive Afatgjata Materiale		37,618,064	30,809,328
Ndertesat		52,409,584	55,167,983
Makineri dhe pajisje		6,834,483	7,948,878
Mjete Transporti		305,280	381,600
Aktive te tjera afatgjata materiale (neto)		37,618,064	30,809,328
Totali	9	97,167,411	94,307,789
Aktive Biologjike Afatgjate		-	-
Aktive Afatgjata Jomateriale		-	-
Totali		-	-
Kapitali aksionar i papaguar		-	-
Aktive te tjera afatgjata (ne proces)		-	-
Total i Aktiveve Afatgjata		97,167,411	94,307,789
TOTALI I AKTIVEVE		120,704,496	110,039,649

Aurel Plasa

Hartuese e Pasqyrave Financiare

Sotir Dhamo

Administrator

Shenimet ne vijim jane pjese e pandashme e pasqyrave financiare

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2012 (vazhdim)

DETYRIMET DHE KAPITALI	Shenime	31.12.2012	31.12.2011
Detyrimet Afatshkurta			
Derivatet		-	-
Huamarrjet		-	-
Huate afatshkurtra	10	12,973,139	6,806,700
Kthimet/Ripagimet e huave afatgjata		-	-
Bono te konvertueshme		-	-
Totali		12,973,139	6,806,700
Huate dhe parapagimet			
Te pagueshme ndaj furnitoreve	11	10,184,803	2,839,724
Te pagueshme ndaj punonjesve	12	528,903	59,028
Detyrimet tatiimore	13	2,637,416	2,837,410
Te tjera detyrime		-	-
Parapagimet e arketueshme		-	-
Totali		13,351,122	5,736,162
Grantet dhe te ardhura te shtyra	14	29,551,374	48,455,904
Provizionet afatshkurtra		-	-
Totali Detyrime Afatshkurtra		55,875,635	60,998,766
Detyrimet Afatgjata			
<i>Huate afatgjata</i>			
Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare		-	-
Bonot e konvertueshme		-	-
Totali			
Huamarrje te tjera afatgjata		39,537,515	36,324,760
Provizionet afatgjata		-	-
Grandet dhe te ardhura te shtyra		3,400,302	2,834,499
Totali Detyrime Afatgjata	15	42,937,817	39,159,259
Totali i Detyrimeve		98,813,452	100,158,025
Kapitali			
Akisonet e pakices		-	-
Kapitali i aksionereve te shoqerise meme		-	-
Kapitali i aksionar	16	100,000	100,000
Primi i aksionit		-	-
Njesite ose aksionet e thesarit		-	-
Rezerva statutore		-	-
Rezerva ligjore		-	-
Rezerva te tjera		9,781,624	-
Fitimi i pashperndare		-	(5,979,908)
Fitimi (humbje) e vitit financiar	23	12,009,420	15,761,533
Totali i Kapitalit		21,891,044	9,881,625
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		120,704,496	110,039,649

Aurel Plasa

Hartuese e Pasqyrave Financiare

Sotir Dhamo

Administrator



PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2012

Te ardhura e shpenzime	Shenime	31.12.2012	31.12.2011
Te Ardhurat	17	228,241,450	198,857,813
Shitjet neto		217,856,799	198,537,292
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit		10,384,651	320,521
Ndryshimi I gjendjes Prodh.proces		-	-
Materialet e konsumuara		-	-
Kosto e punës	18	(101,543,416)	(72,899,134)
-pagat e personelit		(90,792,285)	(65,174,049)
-shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore		(10,751,131)	(7,725,085)
-shpenzime per honorare		-	-
Amortizimet dhe zhvlerësimet	19	(10,843,268)	(10,215,358)
Shpenzime të tjera	20	(101,792,430)	(96,716,603)
Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)		(214,179,114)	(179,831,095)
Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore(1+2+/-3-8)		14,062,336	19,026,718
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara			
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet			
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare		(307,451)	(1,142,161)
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera fir		-	-
Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	21	(414,746)	(1,036,507)
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	22	(54,757)	(196,195)
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare		162,051	90,541
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare(12.1+/-12.2+/-		(307,451)	(1,142,161)
Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)		13,754,884	17,884,558
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin		(1,745,464)	(2,123,025)
Tatim Fitimi i Shtyre			
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar(14-15)	23	12,009,420	15,761,533

Aurel Plasa

Hartuese e Pasqyrave Financiare

Sotir Dhano

Administrator



Universiteti POLIS sh.p.k

Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2012

Pasqyra e fluksit monetar-Metoda indirekte	Viti 2012 ne LEK	Viti 2011 ne LEK
Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit		
Fitimi para tatimit	13,754,884	17,884,558
Rregullime per:		
Amortizimin	10,843,268	10,215,358
Humbje nga kembimet valutore		
Shpenzime per tatim fitim		
Shpenzime per interesa		
(Rritje) / renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesa te arketueshme te tjera	(6,855,952)	282,765
(Rritje) / renie ne tepricen e inventarit	(1,029,880)	
Rritje / (renie) ne tepricen e detyrimeve, per tu paguar nga aktiviteti	(1,344,573)	8,289,838
(Rritje) /Renie ne shpenzimet e shtyra	(2,324,684)	401,125
Interesi i paguar		
Tatim mbi fitimin i paguar	(1,745,464)	(2,123,025)
MM neto nga aktivitetet e shfrytezimit	11,297,599	34,950,619
Fluksi monetar nga veprimtarite investuese		
Blerja e shoqerise se kontrolluar X minus parate e arketuara		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(13,702,890)	(40,307,932)
Te ardhura nga shitja e paisjeve		
Interesi i arketuar		
Dividentet e arketuar		
MM neto e perdorur ne aktivitetet investuese	(13,702,890)	(40,307,932)
Fluksi monetar nga veprimtarite financiare	-	-
Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner		
Rritje Pakesim I detyrimeve te ortakeve		
Pagesat e detyrimeve te qirase financiare		
Dividentet e paguar		
MM neto e perdorur ne aktivitetet financiare	-	-
Rritja / renia neto e mjeteve monetare	(2,405,291)	(5,357,313)
Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel	5,803,849	11,161,163
Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	3,398,558	5,803,849

Shenimet e Pasqyrave Financiare nga faqja 7-17 jane pjese e pandashme e tyre

Aurel Plasa

Hartuese e Pasqyrave Financiare

Sotir Dharmo

Administrator



Universiteti POLIS sh.p.k

Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2012


	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore statutore	Rezerva te tjera	Fitimi i pashpërndarë	Fitimi i Ushtrimit	Totali
Pozicioni më 01.01.2011	100,000	-	-	(17,023,036)	11,043,128	(5,879,908)
Fitimi neto për periudhën kontabël						-
Transferuar ne fitim(humbje te mbartur)				11,043,128	(11,043,128)	15,761,533
Dividendët e paguar						-
Pozicioni më 31.12.2011	100,000	-	-	(5,979,908)	15,761,533	9,881,625
Fitimi neto për periudhën kontabël						12,009,420
Transferuar ne fitim(humbje te mbartur)				5,979,908	(15,761,533)	(9,781,625)
Transferuar ne Rezerva te tjera			9,781,624			9,781,624
Pozicioni më 31.12.2012	100,000	-	9,781,624	-	12,009,420	21,891,044

Aurel Plasa

Hartuese e Pasqyrave Financiare

Sotir Dharmo

Administrator



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

1. TE DHENA TE PERGJITHSHME MBI SHOQERINE

Shoqeria "Universiteti POLIS" sh.p.k. është krijuar me 30/03/ me nr. Vendimi 35.386 date 04.04.2006.

Aktiviteti kryesor i shoqerise eshte :

Krijimi I Universitetit Polis ,shkolle Nderkombetare e Arkitektures dhe Politikave te Zhvillimit Urban,me dege Fakulteti I Arkitektures dhe Dizanjn ,Fakulteti I Planifikimit,Mjedisit dhe Menaxhimit Urban.Trajnim ,kryerje te kurseve ,seminareve,konferencave te nivelit Universitar dhe pas Universitar ,kombetar dhe nderkombetar.

Kaptali është 100.000 lekë dhe I ndare ne 100 kuota me vlere nominale 1.000 leke /kuote.

Selia e shoqërisë është : Kashar Autostrada Tirane –Durrës
Perfaqesues Ligjor është Z. Sotir Dhamo

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.2 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.3 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyre të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.



3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat të paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

	31.12.2012	31.12.2011
Kurse e kembimit		
Euro/Leke	139.59	138.93
USD/ Leke	105.85	107.54

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (Mjete monetare)

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që



llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe nuk është amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshire koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali njihet me vlerën nominale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



iii. *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi vleren e mbetur. Amortizimi llogaritet duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Per llogaritjen e amortizimit jane aplikuar keto norma amortizimi:

Llojet e "Aktiveve Afat Gjata Materjale"	Normat e aplikuar	Metoda e aplikuar
Ndertesa	5%	Me vlere te mbetur
Mjete transporti	20%	Me vlere te mbetur
Pajisje zyresh	20%	Me vlere te mbetur
Pajisje kompjuterike dhe sisteme informacioni	25%	Me vlere te mbetur
Te tjera AQT	20%	Me vlere te mbetur

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 *Zhvlerësimi*i. *Aktivët financiarë*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 *Provizionet*

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, kur Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 *Njohja e të ardhurave*

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i prishëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

4. LIKUIDITETE DHE VLERA TE TJERA ARKE.

Gjendja e likuiditeteve rakordon me shumën e ekstrakteve të bankave dhe gjendjes së arkës në 31.12.2012. Shoqëria ka llogari bankare në leke dhe në valute. Për gjendjet në valute është bërë rivlerësimi me kursin fikse të Bankës së Shqipërisë në dt. 31.12.2012 dhe diferencat janë pasqyruar në rezultatin e shoqërisë

	2012 <i>ne LEK</i>	2011 <i>ne LEK</i>
Vlera monetare ne LEK	2,505,243	1,375,437
Banka	1,695,937	505,637
Arka	809,306	869,800
Vlera monetare ne Valute	893,315	4,428,412
Banka	347,518	3,418,391
Arka	545,797	1,010,021
Total	3,398,558	5,803,849

5. KERKESA TE ARKETUESHME

Shuma e pasqyruar në bilanc përfaqëson kërkesat për arketim ndaj klienteve të shoqërisë. Kjo shumë përfaqëson detyrimin e të tregëve ndaj shoqërisë për fatura të palikuiduara. Te gjitha kërkesat janë të arkëtueshme. Për klientet në valute është bërë rivlerësimi i tyre me kursin fikse të bankës së Shqipërisë dhe diferencat janë paraqitur në pasqyrën e rezultatit të ushtrimit.

	2012 <i>ne LEK</i>	2011 <i>ne LEK</i>
Kliente	7,286,212	3,945,656
Total	7,286,212	3,945,656



Universiteti POLIS sh.p.k

Shenimet per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, perveç kur shprehet ndryshe)

6. TE TJERA KERKESA PER ARKETIM

Ne kete ze paraqitet tatim fitimi i mbipaguar, dhe debitore te tjere si me poshte:

	<u>2012</u> <i>ne LEK</i>	<u>2011</u> <i>ne LEK</i>
Tatim Fitimi	577,560	
Debitore te tjere	7,809,592	4,871,756
Total	8,387,152	4,871,756

Tatim fitimi i mbipaguar analizohet si me poshte:

	<u>2,012</u> <i>ne LEK</i>
Tatim Fitim i mbartur	-
Tatim Fitimi i derdhur gjate periudhes	2,323,024
Tatim Fitim i parapaguar	2,323,024
Tatim Fitimi viti ushtrimor 2012	1,745,464
Tatim Fitim paguar me teper	577,560
Tatim Fitim per t'u paguar	-

Debitore te tjere eshte paraqitur me vleren neto pas zhvleresimit.

	<u>2012</u> <i>ne LEK</i>
Debitore te tjere	8,974,753
Zhvlersimi per debitore te tjere	(1,165,161)
Total	7,809,592

7. INVENTARET

Ne kete ze paraqiten libra te blera nga shoqeria te cilat do te shiten ne periudhat ne vijim por qe me 31.12.2012 rezultojne gjendje.

	<u>2012</u> <i>ne LEK</i>	<u>2011</u> <i>ne LEK</i>
Libra	1,029,880	
Total	1,029,880	-

8. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TE SHTYRA

Shuma prej 11,244,875 leke e ketij posti lidhet me shpenzime te cilat jane realizuar gjate vitit 2012 por qe efektin e shtrijne pas kesaj periudhe .

	<u>2012</u> <i>ne LEK</i>	<u>2011</u> <i>ne LEK</i>
Shpenzime te shytyra	3,435,283	1,110,599
Total	3,435,283	1,110,599

Universiteti POLIS sh.p.k

Shenimet per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

12. TE PAGUESHME NDAJ PUNONJESVE

	<u>2012</u>	<u>2011</u>
	<u>ne LEK</u>	<u>ne LEK</u>
Te pagueshme ndaj punonjesve	528,903	59,028
Total	528,903	59,028

13. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore perfaqesojne detyrimet e muajit Dhjetor 2012 te cilat jane likujduar ne Janar 2013 dhe paraqiten si me poshte:

	<u>2012</u>	<u>2011</u>
	<u>ne LEK</u>	<u>ne LEK</u>
Sigurime Shoq. & Shendetsore	1,668,067	1,418,199
Tatim mbi te ardhurat personale	838,851	759,670
Tatim Fitimi	-	507,575
Tatim ne burim	126,227	142,351
Tvsh per tu paguar	4,271	9,616
Total	2,637,416	2,837,410

14. GRANTE DHE TE ARDHURA TE SHTYRA

Ne kete ze jane paraqitur parapagimet e studenteve te cilat i takojne vitit 2013.

	<u>2012</u>	<u>2011</u>
	<u>ne LEK</u>	<u>ne LEK</u>
Te ardhura te shtyra afatshkurter	29,551,374	48,455,904
Total	29,551,374	48,455,904

15. HUAMARRJE AFATGJATA

Ne kete ze eshte perfshire huate e tjera te marra per zhvillimin e aktivitetit te kompanise.

	<u>2012</u>	<u>2011</u>
	<u>ne LEK</u>	<u>ne LEK</u>
Huamarrje te tjera Afatgjata	39,537,515	36,324,760
Total	39,537,515	36,324,760



Universiteti POLIS sh.p.k

Shenimet per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, perveç kur shprehet ndryshe)

16. GRANTET DHE TE ARDHURA TE SHTYRA AFATGJATA

Ne kete ze eshte paraqitur pjesa e mbetur e granteve per AAM te cilat paraqiten per vleren neto te tyre. Per cdo vit ushtrimor shoqeria kalkulon pjesen e amortizimit te ketyre AAM te cilat paraqiten ne pasqyren e amortizimit dhe per te njejten vlere ajo ben paraqitjen ne te ardhura te tjera te kesaj kuote amortizimi. Si rezultat paraqitja ne rezultat per mjetet e marra falas eshte 0.

	<u>2012</u> <u>ne LEK</u>	<u>2011</u> <u>ne LEK</u>
Grante afatgjata	3,400,302	2,834,499
Total	3,400,302	2,834,499

	<u>2012</u> <u>ne LEK</u>
Vlera e Grantit	3,717,996
Kuota e amortizimit kaluar ne te ardhura	(317,694)
Total	3,400,302

17. KAPITALI I VET

a. Kapitali I nenshkruar

Kapitali in nenshkruar eshte paraqitur ne këtë ze për vlerën 100,000 lekë.

b. Rezerva te tjera

Rezerva te tjera per investime paraqitet per shumen 9,781,624 leke.

c. Fitime ose humbje te ushtrimit

Ne kete ze eshte paraqitur fitimi neto i vitit ushtrimor pas llogaritjes se tatimit mbi fitimin ne shumen 12,009,420 leke.

18. TE ARDHURAT

Te ardhurat jane realizuar nga veprimtaria kryesore e shoqerise si me poshte:

	<u>2012</u> <u>ne LEK</u>	<u>2011</u> <u>ne LEK</u>
Te ardhura nga shitja	217,129,865	198,537,292
Te ardhura te tjera	4,026,509	-
Te ardhura te tjera nga financime	6,767,382	-
Te ardhura nga grantet	317,694	320,521
Total	228,241,450	198,857,813



Universiteti POLIS sh.p.k

Shenimet per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, perveç kur shprehet ndryshe)

Gjate vitit 2012 te ardhurat e realizuar nga shitjet e sherbimeve te shoqerise jane 228,241,450 leke ndersa te deklarura ne FDP paraqiten ne shumen.209,019,226 leke. Diferenca me te ardhurat ne kontabilitet shpjegohet si me poshte:

Te ardhura te marra nga viti 2011	48,455,904
Shitje faturuar gjate vitit 2012	209,019,226
Te ardhura te shyra ne vitin 2013	(29,551,374)
Te ardhura nga grantet	317,694
Te ardhurat e ushtrimit	228,241,450

19. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit perbehen nga shpenzimet per paga dhe shpenzimet per sigurime shoqerore e shendetesore. Keto shpenzime perputhen me shpenzimet e deklaruar gjate vitit 2012.

	2012 ne LEK	2011 ne LEK
Pagat e personelit	90,792,285	65,174,049
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	10,751,131	7,725,085
Total	101,543,416	72,899,134

20. SHPENZIMET E AMORTIZIMIT

	2012 ne LEK	2011 ne LEK
Shpenzimi Amortizimi	10,843,268	10,215,358
Total	10,843,268	10,215,358

21. SHPENZIME TE TJERA ADMINISTRATIVE

Shpenzimet e tjera administrative jane analizuar ne tabelen e meposhtme:

	2012 ne LEK	2011 ne LEK
Qera	50,353,200	50,531,400
Kancelari	1,597,891	1,479,158
Shpenzime uje/energji	3,243,504	2,484,922
Shpenzime pastrimi	994,589	1,639,437
Komisione bankare	495,842	629,903
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	824,445	840,440
Shpenzime reklame	4,492,153	3,500,655
Mirembjatje dhe riparime	2,070,227	1,870,519
Shpenzime konsulence	12,931,514	1,313,438
Shpenzime interneti	390,200	1,096,353
Shpenzime te tjera	24,398,864	31,330,378
Total	101,792,430	96,716,603

Universiteti POLIS sh.p.k

Shenimet per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, perveç kur shprehet ndryshe)

22. TE ARDHURA DHE SHPENZIME NGA INTERESA

	<u>2012</u>	<u>2011</u>
	<u>ne LEK</u>	<u>ne LEK</u>
Shpenzime per interesa	(451,305)	(1,050,337)
Te ardhura nga interesat	36,560	13,831
Total	(414,746)	(1,036,507)

23. FITIM (HUMBJE) NGA KURSI I KEMBIMIT

Diferencat nga ndryshimi i kursit te kembimit jane paraqitur neto ne Pasqyren e Rezultatit dhe perbehen nga fitime/(humbje) perkatesisht sipas tabelës se meposhtme:

	<u>2012</u>	<u>2011</u>
	<u>ne LEK</u>	<u>ne LEK</u>
Humbje nga kursi i kembimit	(339,271)	(674,370)
Fitime nga kursi i kembimit	284,514	478,175
Total	(54,757)	(196,195)


24. STRUKTURA E REZULTATIT TATIMOR

Struktura e rezultatit me 31 dhjetor 2012 paraqitet si me poshte:

	<u>2,012</u>	<u>2011</u>
	<u>ne LEK</u>	<u>ne LEK</u>
Rezultati tatimor		
Fitimi/(Humbja) para tatimit	13,754,884	17,884,558
Fitim/Humbje te mbartura	-	(99,431)
Shpenzime te panjohura	3,699,760	3,445,124
Fitimi fiskal	17,454,644	21,230,250
Tatim fitimi (10 %)	(1,745,464)	2,123,025
Fitimi/(Humbja) Neto	12,009,420	15,761,533

25. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.


Aurel Plasa
Hartues i Pasqyrave Financiare


Sotir Dhano
Administratar

